



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-62051

Datë: 03.07.2024

Prizren

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike - DSHP me seli në Prizren, e në bazë të nenit 3.alinea 1 pikat 1.1, 1.2, 1.4,1.14, 1.17, 1.20,1.24, e në lidhje me nenin 5 paragrafi1,pika 1.1,1.3 dhe 1.6, si dhe neni 19 alenia 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 si dhe në bazë të nenit 129 të vendimit komunal për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve Komunale nr. 01/011-2 dt.18.11.2004 si dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 dhe 127 LPA-së nr. 05/L-031, si dhe konform nenit 25.1 paragrafi 25. 1.1 të rregullores 02/2022 për Taksat Komunale nr.001/001-99275 dt.30.08.2022 dhe conform Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e parë e mbrojtjes nr.01/011-6604 të dt.18.12.2008 , lëshon këtë:

AKTVENDIM

- I. **Aprovohet** kërkesa Nr. 04-353/01-62051 e datës 14.05.2024 e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për Realizimin e punimeve në projektin :
-“Vendosja e ormanëve elektrike përkaj murit të shtratit Lumbardhë në rrugën Shuaip Spahiu” në zonën e parë të mbrojtur .
- II. Kërkesa e aprovuar sipas pikes I të dispozitivit të këtij Aktvendimi është si në vijim:
 - Lejohen gjithsej 6 ormane elektrike të vendosen në sipërfaqe të brendshme të murit të shtratit Lumbardh,me kusht që të mos tejkalohet lartësia ekzistuese e murit aktual,dhe të futen brenda murit,kah ana e aksit të trotuarit,duke lërë trashësinë e konsiderueshme të murit ekzistues dhe kah faqja ballore e shtratit me orjentim kah ana veriore e saj,pra dukja veriore e shtratit të murit nuk duhet ndryshuar pamjen e saj,e cila është prej materialit të gurit.
 - Kapakët e orormanëve duhet të jenë në harmoni me materialet e aplikueshme dhe atyre të shfrytëzueshme për brenda zones historike,pra dru ose material guri. Kapakët të mveshen me elemente të drurit,për shkak të mirëmbajtjes dhe natyrës së realizimit
- III. Dokumentacioni teknik -Projekti Kryesor i punuar nga byroja projektuese “Smart Architecture” N.SH.
- IV Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh dhe obligohet që të njoftojë QRTK-Prizren 7 ditë para fillimit të punimeve.

IV. Hunjëzimi të bëhet sipas dokumentacioni teknik..

Investitori është i obliguar që punimet të kryhen në bazë të dokumentacionit teknik-projektit e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullat të përkohshme teknike për kësi llojë punime .

V. Investitori duhet të përmbahet pëlqimeve:

- Vendim I QRTK-së me nr.93/5 të dt.29.05.2024
- Rekomandimi I KTKQHP të dt. 07.06.2024.

VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.

VII. Pas përfundimit të punimeve Investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.

A r s y e t i m

Drejtoria e Shërbimeve Publike -DSHP me seli në Prizren është drejtuar këtij organi **me kërkesë** për realizimin e projektit : -“Vendosja e ormanëve elektrike përkaj murit të shtratit Lumbardhë në rrugën Shuaip Spahiu” në zonën e pare të mbrojtur .

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës MMPHI-së – Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:



Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.

Drejtori:



Pranverim Berisha,jur